



LËVIZJA PËR BASHKIM

**LËVIZJA PËR BASHKIM
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM**

PLATFORMA POLITIKE E LËVIZJES PËR BASHKIM

**Prishtinë
Shtator, 2008**

PËRMBAJTJA

I. SITUATA POLITIKE NË TROJET SHQIPTARE	3
1. Histori e shkurtër e popullit shqiptar	3
2. Gjendja e popullit shqiptar në Kosovë dhe situata politike	4
a) Situata politike në Kosovë	4
b) Situata politike në veriun e Kosovës	5
c) Gjendja e popullit shqiptar në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë	6
3. Gjendja e popullit shqiptar nën pushtimin maqedonas	7
4. Gjendja e popullit shqiptar nën pushtimin malazez	7
5. Qëndrimi i zyrtar i Republikës së Shqipërisë në lidhje me çështjen e pazgjidhur kombëtare	8
II. QËNDRIME DHE PIKËPAMJE TË LËVIZJES PËR BASHKIM	9
1. Qëndrimi i LB-së në lidhje me çështjen e pazgjidhur kombëtare	9
a) Vetëvendosja e kombeve deri në shkëputje – parimi i vetëm i drejtë për zgjidhjen e çështjeve kombëtare	9
b) Zgjidhje parciale apo e tërësishme (e menjëhershme) e çështjes shqiptare	9
c) Veriu i Kosovës - Presheva, Bujanoci e Medvegja	10
d) Sovraniteti i Kosovës dhe bashkimi kombëtar	10
e) Integrimet kombëtare dhe çështja e pazgjidhur kombëtare	11
f) Integrimet ndërkombëtare dhe bashkimi kombëtar	11
g) Pakicat kombëtare	12
2. Prezenca ndërkombëtare në Kosovë	13
3. Rezoluta 1244 e OKB-së.....	13
4. Pakoja e Ahtisarit.....	14
5. Kushtetuta e Kosovës.....	14
6. Qëndrimi i LB-së për zgjedhjet dhe qeverisjen në Kosovë.....	15
a) Zgjedhjet e lira në Kosovë.....	15
b) Pjesëmarrja e LB-së në zgjedhje	16
c) Pjesëmarrja e LB-së në qeverisje.....	16
d) Zgjedhjet, vota dhe pushteti.....	17
7. Qeverisja dhe interesi i përditshëm i qytetarit	17
III. ÇËSHTJET TË CILAT KËRKOJNË PËRQENDRIM NË PERIU DHËN DYVJEÇARE	18

I

SITUATA POLITIKE NË TROJET SHQIPTARE

1) Histori e shkurtër e popullit shqiptar

Populli shqiptar, pasardhës i drejtpërdrejtë i ilirëve, që në kohërat e lashta populloi pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik. Gjatë gjithë historisë së tij ky popull bëri përpjekje të shumta për ta ruajtur identitetin dhe truallin e tij kombëtar.

Që nga luftërat e hershme kundër pushtimeve romake, pastaj kundër bizantinëve e Perandorisë Osmane, e deri te përpjekjet për zbrapsjen e dyndjeve të sllavëve të jugut, historia e popullit shqiptar ka qenë një histori e pandërprerë për çlirimin dhe bashkimin e truallit të tij.

Si rezultat i këtyre luftërave e përpjekjeve për liri e bashkim, më 1912 erdhi deri te shpallja e Pavarësisë dhe formimi i shtetit shqiptar. Pa dyshim se kjo është data më e rëndësishme në tërë historinë e këtij populli.

Fuqitë e Mëdha të kohës e njohën formimin e shtetit të ri shqiptar, por njëkohësisht njohën edhe pushtimin e më tepër se gjysmës së tokave shqiptare nga ana e fqinjëve të Shqipërisë. Së pari në Kongresin i Berlinit (1878), e pastaj edhe në Konferencën e Londrës (1913), Fuqitë e Mëdha vendosën kundër vullnetit të popullit shqiptar dhe me vendimin e tyre e vulosën njërën nga padrejtësitë më të mëdha të shekullit të njëzetë.

Sot territoret e banuara me shumicë shqiptare gjenden të ndara në pesë shtete. Populli shqiptar as nuk është pajtuar, e as nuk do të pajtohet me këtë copëtim të truallit të tij dhe do t'i vazhdojë përpjekjet për bashkimin e tij në një shtet të vetëm.

2) Gjendja e popullit shqiptar në Kosovë dhe situata politike

a) Situata politike në Kosovë

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, Kosova dhe shumë vise të tjera të banuara me shumicë shqiptare u shkëputën padrejtësisht nga shteti i sapoformuar shqiptar dhe u aneksuan nga fqinjët grabitqarë.

Prej atëherë e deri në përfundim të luftës së fundit të popullit shqiptar kundër pushtuesit serb (1998-1999), Kosova ishte nën sovranitetin serbo-jugosllav.

As pas shumë ndryshimeve në statusin politik të Kosovës, shqiptarët, të cilët e përbëjnë shumicën dërrmuese të banorëve të saj (mbi 90%), nuk janë sovranë në tokën e tyre dhe nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje.

Situata e brendshme politike në Kosovë dhe pozita e saj ndërkombëtare paraqiten mjaft të ndërlikuara. Të ndërlikuara janë edhe koniunkturat ndërkombëtare që e kanë sjellë Kosovën në këtë pozicion.

Deri në vitin 1999 ndikimi i politikës së faktorëve kryesorë ndërkombëtarë në Kosovë nuk ishte i drejtpërdrejtë. Pas luftës së popullit shqiptar të viteve 1998-99 të udhëhequr nga UÇK-ja (si rrjedhojë e së cilës erdhi deri tek intervenimi ushtarak i NATO-s) në Kosovë u vendos administrata ndërkombëtare – UNMIK, në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Nga kjo periudhë përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë (sidomos e SHBA-së, e BE-së dhe e Rusisë) është e drejtpërdrejtë dhe me ndikime parësore për zhvillimet e saj politike.

Si rezultat i koniunkturave ndërkombëtare, por edhe i zhvillimeve të brendshme (ku kishte një rritje të vazhdueshme të pakënaqësisë së shqiptarëve për moszgjidhjen e statusit politik të Kosovës), në fillim të vitit 2006, nën mbikëqyrjen dhe ndërmjetësimin e OKB-së, përmes të deleguarit të saj special Marti Ahtisarit, filluan negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Ky proces përfundoi pa ndonjë marrëveshje në mes të palëve, por me një dokument të prezantuar nga ndërmjetësi Marti Ahtisari të quajtur Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (i njohur si Pakoja e Ahtisarit), për të cilin palët duhej të deklaroheshin.

Pas mospajtimit të Serbisë me këto propozime (sidomos me atë për pavarësi të mbikëqyrur), Rusia e bllokoi kalimin e këtij dokumenti në KS të OKB-së. Si rezultat, negociatat vazhduan deri në vjeshtë të vitit 2007. Pas dështimit përfundimtar të negociatave, më 17 shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli *Deklaratën e Pavarësisë*, e cila shënoi edhe shkëputjen formale nga Serbia.

Ky ishte një hap pozitiv në përpjekjet e gjata të popullit shqiptar për shkëputje nga Serbia, ndonëse çështja e tri komunave me shumicë shqiptare të

mbetura nën Serbi - Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, as nuk u hodh në tryezën e bisedimeve, e as nuk u përfshi në Marrëveshjen e Ahtisarit.

Presheva, Bujanoci e Medvegja, së bashku me veriun e Kosovës përbëjnë problemin më të mprehtë të marrëdhënieve shqiptaro-serbe.

Kjo situatë e komplikuar politike në të cilën ndodhet Kosova po lë gjurmë edhe në zhvillimet në fushën socio-ekonomike. Ngecjet në fushën ekonomike kanë bërë që varfëria ekstreme të rritet nga viti në vit. Në të njëjtën kohë ka një rënie të madhe të nivelit të arsimit, të kulturës e të shëndetësisë. Tërë kjo situatë po e shkakton një krizë të madhe shoqërore dhe rënie të vlerave morale.

Kasta e sotme politike e Kosovës është treguar e papërgjegjshme ndaj kësaj situatë. Ajo, qoftë për shkak të paaftësisë, qoftë për shkak të servilizmit politik apo për shkak të përfitimeve të saj nga kjo situatë, asnjëherë nuk ka dalë me një strategji kombëtare apo me një vizion të qartë për zgjidhjen e problemeve të shumta të Kosovës dhe popullit të saj.

Shumë nga problemet që u theksuan më lart, sidomos ato të natyrës socio-ekonomike, mund të zgjidhen edhe në kontekstin politiko-juridik në të cilin gjendet Kosova aktualisht, me një politikë më të përgjegjshme të institucioneve ndaj interesave të qytetarëve dhe me një trajtim krejt të ndryshëm të këtyre problemeve. Përndryshe, problemet politike, sidomos ato që kanë të bëjnë me sovranitetin, mund të zgjidhen vetëm atëherë kur populli shqiptar i Kosovës si popull shumicë do ta realizojë të drejtën e vet të patjetërsueshme për vetëvendosje të kombeve deri në shkëputje.

Lëvizja për Bashkim do të punojë me ngulm në organizimin e popullit, në mënyrë që ai ta kthejë besimin e humbur në forcën e vet dhe të bëhet kreator i jetës së vet. Njëkohësisht Lëvizja për Bashkim do të përpiqet për realizimin e së drejtës së mohuar të popullit shqiptar për vetëvendosje dhe që kjo e drejtë të shkojë në drejtim të bashkimit të Kosovës me Republikën e Shqipërisë.

b) Situata politike në veriun e Kosovës

Që nga fundi i luftës, Serbia herë fshehur, e herë hapur e ka kontrolluar veriun e Kosovës dhe në bashkëpunim me UNMIK-un e ka ndarë sovranitetin mbi këtë pjesë të Kosovës. Për më tepër, Serbia, përmes eksponentëve të saj më ekstremë në këtë pjesë të Kosovës dhe përmes pjesëtarëve të organeve të saj policore, si dhe me bekimin e heshtur të faktorëve ndërkombëtarë, e ka spastruar veriun e qytetit të Mitrovicës nga popullata e saj shumicë - shqiptarët. Kjo situatë e rëndë për shqiptarët e kësaj pjese të Kosovës, është përcjellë me një indiferencë të plotë të institucioneve të Kosovës.

As pas shpalljes së pavarësisë institucionet e Kosovës nuk e ushtrojnë pushtetin në këtë rajon. Atje as administrata ndërkombëtare nuk e ushtron

pushtetin, kështu që pushteti i serbëve mbi veriun e Kosovës tani është i padiskutueshëm. Mbajtja e zgjedhjeve serbe në maj të këtij viti dhe zgjedhja e udhëheqësve komunalë serbë ishte vetëm preludi i kësaj krize të paralajmëruar më herët.

Të gjitha këto probleme të mprehta që kanë dalë në pah që në vitin 1999, si dhe duke qenë se serbët në këtë pjesë janë shumicë dërrmuese dhe kanë lidhje territoriale me Serbinë, dëshmojnë se pozita e serbëve në veriun e Kosovës nuk mund të trajtohet si e atyre në pjesët e tjera të Kosovës. Si rrjedhim, veriu i Kosovës mbetet çështje e pazgjidhur e marrëdhënieve shqiptaro-serbe dhe kërkon trajtim të veçantë e të kujdesshëm.

c) Gjendja e popullit shqiptar në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë

Komunat shqiptare të mbetura nën Serbi janë produkt i politikës kolonialiste serbe ndaj shqiptarëve.

Populli shqiptar që jeton në këtë rajon i është nënshtruar historikisht një shtypjeje të vazhdueshme që për qëllim përfundimtar kishte asimilimin apo dëbimin e shqiptarëve nga trojet e veta. Në një pjesë të kësaj treve (në komunën e Medvegjës, e pjesërisht në atë të Bujanocit) kjo politikë edhe i ka arritur disa rezultate. As pas luftës së vitit 2001 që u udhëhoq nga UÇPMB-ja pozita e shqiptarëve nuk u përmirësua. Për më tepër, ajo është keqësuar vazhdimisht.

Kjo pjesë e popullit shqiptar për një kohë të gjatë ka qenë peng i zhvillimeve në Kosovë. Populli shqiptar atje shpeshherë ka sakrifikuar edhe në dëm të të drejtave të veta vetëm e vetëm që statusi politik i Kosovës të përparojë. Kjo pjesë e popullit shqiptar ka qenë në shërbim aktiv në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Kështu që ka ardhur koha që edhe pjesa tjetër e kombit, sidomos Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, ta trajtojnë me kujdes të veçantë çështjen e komunave shqiptare të mbetura nën Serbi dhe të popullit shqiptar atje.

Mbi të gjitha, shqiptarët në këtë pjesë nuk mund të trajtohen si pakicë kombëtare dhe çështja e tyre nuk mund të zgjidhet përmes realizimit të të drejtave të pakicave. Kjo sepse ata përveç që janë shumicë në territorin ku banojnë, kanë edhe lidhje territoriale të pashkëputura me shqiptarët në Kosovë. Kjo bën që ata të jenë pjesë e ndarë e kombit shqiptar dhe si të tillë të kenë të drejtë në realizimin e së drejtës së kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje. Deri në momentin e realizimit të kësaj të drejte, ata duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat të parashikuara dhe të realizuara nga serbët në veriun e Kosovës.

3) Gjendja e popullit shqiptar nën pushtimin maqedonas

Situata politike në territoret e banuara me shumicë shqiptare në Maqedoni vazhdon të mbetet mjaft e rëndë. Ndjekjet, burgosjet, ekspeditat ndëshkuese, e deri te mohimi ligjor i të drejtave kombëtare të shqiptarëve janë karakteristikat e kësaj gjendjeje.

Lufta e fundit në Maqedoni përfundoi me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, në të cilën popullit shqiptar nuk i njihen më shumë se të drejtat e pakicës kombëtare.

Madje edhe ato pak të drejta të sanksionuara me Marrëveshjen e Ohrit shkelen për çdo ditë nga ana e pushtetit maqedonas.

Partitë politike shqiptare që veprojnë në Maqedoni që nga përfundimi i luftës e këtej nuk kanë bërë gjë tjetër përveç garës për pushtet, në të cilën garë paraprakisht është ditur se do të jetë i pashmangshëm një koalicion me partitë nacionaliste maqedonase ku partitë politike shqiptare do të jenë një pakicë e mbivotuar në kuadrin e pushtetit maqedonas. Duke qenë ky një fakt i pakundërshtueshëm, propaganda e partive politike shqiptare se do t'i mbrojnë interesat kombëtare të shqiptarëve në kuadër të institucioneve të shtetit maqedonas mbetet vetëm një farsë e thjeshtë.

Lëvizja për Bashkim, duke u nisur nga fakti se populli shqiptar në Maqedoni gjendet në situatë të pushtimit klasik, deklaroi hapur se shqiptarët në Maqedoni janë komb dhe u takon e drejta e vetëvendosjes së kombeve deri në shkëputje dhe se ky interes madhor nuk mund të mbrohet nëpërmjet institucioneve maqedonase.

4) Gjendja e popullit shqiptar nën pushtimin malazias

Populli shqiptar që jeton në trojet e veta nën pushtimin e Malit të Zi i është nënshtruar në vazhdimësi një politike të egër shpërnguljeje, asimilimi e mohimi të të drejtave kombëtare. Si rezultat i drejtpërdrejtë i një politike të tillë, numri i banorëve shqiptarë që jetojnë nën Malin e Zi ka shkuar duke u zvogëluar në mënyrë drastike. Qoftë për shkak të asimilimit (shqiptarët në vazhdimësi shndërrohen në “myslimanë” apo boshnjakë), qoftë për shkak të shpërnguljes (në drejtim të vendeve evropiane, e sidomos në Amerikën e largët), territore të tëra dikur të banuara me shqiptarë tani ose janë të populluara me malazez, boshnjakë e “myslimanë”, ose kanë mbetur të shkretuara fare. Kjo bën që gjendja e popullit shqiptar nën Malin e Zi të jetë në situatën më të vështirë nga të gjitha trojet e tjera shqiptare.

Edhe pas pavarësisë së Malit të Zi më 2006 pushteti malazias vazhdon politikën e njëjtë shkombëtarizuese të paraardhëseve të tij.

Politika shqiptare, duke përfshirë këtu edhe politikën zyrtare të Shqipërisë, ka qenë krejtësisht indiferente ndaj një situatë të tillë.

5) Qëndrimi i zyrtar i Republikës së Shqipërisë në lidhje me çështjen e pazgjidhur kombëtare

Që nga viti 1912 e deri në ditët e sotme, Shqipëria, duke qenë se ka dalë nga robëria e gjatë dhe e pandërprerë, duke qenë e cunguar si dhe duke u ndodhur në rrethana të vështira ndërkombëtare, është ballafaquar vazhdimisht me vështirësi ekonomike e politike; madje nëpër faza të caktuara ka qenë edhe në rreziqe të ricopëtimit.

I kushtëzuar nga këto rrethana, as sot shteti shqiptar nuk ka arritur që ta ketë një qëndrim të qartë e të drejtë në raport me çështjen e pazgjidhur shqiptare. Trajtimi i popullit shqiptar në Maqedoni, në Mal të Zi e në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë si një pakicë kombëtare dhe angazhimi për të drejtat e këtyre “pakicave” në kuadër të Maqedonisë, Malit të Zi e të Serbisë ka qenë dhe mbetet gabimi më i madh i politikës zyrtare të Shqipërisë.

Megjithatë, në raport me çështjen e Kosovës Shqipëria ka ndjekur një politikë më parimore: ajo ka qenë pasqyrim i drejtpërdrejtë i kërkesave të lëvizjes politike në Kosovë dhe është shprehur përmes mbështetjes së kërkesave të shqiptarëve të Kosovës.

Lëvizja për Bashkim mendon se ka ardhur koha që Republika e Shqipërisë ta ndjekë një politikë plotësisht të hapur ndaj çështjes shqiptare dhe të deklarojë botërisht se Shqipëria është copëtuar padrejtësisht më 1912 dhe se popullit shqiptar që jeton në Kosovë, Serbi, Maqedoni e Mal të Zi i takon e drejta e kombeve për vetëvendosje.

II

QËNDRIME DHE PIKËPAMJE TË LËVIZJES PËR BASHKIM

1) Qëndrimi i LB-së në lidhje me çështjen e pazgjidhur kombëtare

a) Vetëvendosja e kombeve deri në shkëputje – parimi i vetëm i drejtë për zgjidhjen e çështjeve kombëtare

Procesi i zgjidhjes së çështjeve dhe problemeve kombëtare në Ballkan mbetet i papërfunduar edhe sot e kësaj dite. Janë pikërisht këto çështje që e lënë Ballkanin në një jostabilitet të vazhdueshëm politik, e si rrjedhojë edhe në prapambetje ekonomike.

Lëvizja për Bashkim mendon se vetëm aplikimi i plotë i parimit të vetëvendosjes së kombeve deri në shkëputje mundëson zgjidhjen përfundimtare të çështjeve kombëtare në Ballkan. Zbatimi konsekuent i këtij parimi të gjitha shteteve të Ballkanit do t'ua siguronte stabilitetin e jashtëm politik dhe do t'i krijonte kushtet për një fqinjësi të mirë e të ndërsjellë për të gjitha shtetet e Ballkanit. Kjo është mundësia e vetme për ndërtimin e raporteve të shëndosha ndërshtetërore që do të kishte si rezultat zhvillim ekonomik në mbarë rajonin.

b) Zgjidhje parciale apo e tërësishme (e menjëhershme) e çështjes shqiptare

Populli shqiptar gjendet sot i copëtuar në pesë shtete. Në secilin shtet ai ndodhet në rrethana të ndryshme, prandaj edhe qasja ndaj këtyre rrethanave duhet

të jetë e ndryshme. Në qoftë se në Serbi (Preshevë, Bujanoc e Medvegjë), në Maqedoni e në Mal të Zi populli shqiptar gjendet nën pushtim klasik, edhe mjetet e metodat për zgjidhjen e çështjes kombëtare do të ndryshojnë domosdo nga mjetet dhe metodat që do të përdoren në Kosovë. Pikërisht për shkak të gjendjeve dhe rrethanave të ndryshme, të cilat kushtëzojnë edhe mjete e metoda të ndryshme, edhe koha e zgjidhjeve të këtyre problemeve mund të jetë e ndryshme. Lëvizja për Bashkim në raport me këto çështje ndjek një politikë gjithëkombëtare, por mendon se këto çështje mund të zgjidhen edhe pjesë-pjesë dhe zgjidhja e secilës pjesë do të jetë edhe ndihmesë e zgjidhjes së çështjes së pjesës tjetër.

c) Veriu i Kosovës - Presheva, Bujanoci e Medvegja

Në veriun e Kosovës, në ato pjesë ku serbët janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territoriale me Serbinë, Lëvizja për Bashkim serbët nuk i konsideron pakicë kombëtare, por komb. Si rrjedhim, Lëvizja për Bashkim konsideron se komunat e banuara me shumicë serbe në veriun e Kosovës të cilat kanë vazhdimësi territoriale me Serbinë mbeten një problem i pazgjidhur shqiptaro-serb. Në këtë rajon një problem i madh mbetet pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës prej ku shqiptarët janë dëbuar së voni nga vendbanimet e tyre. Kjo çështje kërkon një zgjidhje që do ta kishte parasysh përbërjen kombëtare të qytetit të Mitrovicës para dëbimeve të vitit 1999 të shqiptarëve nga veriu i saj.

Lëvizja për Bashkim njësoj konsideron se shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, për shkak të homogjenitetit etnik dhe lidhjeve territoriale me Kosovën, nuk mund të trajtohen pakicë kombëtare, por komb, andaj edhe mbetet problem që kërkon zgjidhje.

Në këtë situatë të re në të cilën gjendet Kosova, krijohet një mundësi e mirë që konflikti shqiptaro-serb të zgjidhet përfundimisht me zbatimin konsekuent të parimit të vetëvendosjes deri në shkëputje për të dyja kombet. Përderisa kjo zgjidhje kundërshtohet ende nga faktori ndërkombëtar dhe përderisa as në Kosovë, e as në Serbi nuk ka guxim politik t'i hyhet këtij procesi (në Serbi edhe për shkak të faktit se ajo ende nuk ka hequr dorë nga apetitet shoviniste për marrjen e krejt Kosovës nën sundimin e saj), Lëvizja për Bashkim konsideron se populli shqiptar në tri komunat shqiptare të mbetura nën Serbi dhe politika shqiptare në përgjithësi, sidomos në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë, duhet të kërkojë me ngulm që të njëjtat standarde dhe modele të zbatuara për serbët në veriun e Kosovës, të zbatohen edhe në tri komunat e banuara me shumicë shqiptare nën Serbi.

d) Sovraniteti i Kosovës dhe bashkimi kombëtar

Më 17 shkurt 2008 Kosova është shpallur shtet i pavarur e sovran. Mirëpo popullit shqiptar i cili e përbën shumicën dërmuese të popullsisë së Kosovës, nëpërmjet Pakos së Ahtisarit të sanksionuar edhe në Kushtetutën e Kosovës, i

mohohet e drejta e ushtrimit të këtij sovraniteti. Nuk mund të quhet sovran një popull apo një shtet në qoftë se atij i mohohet e drejta themelore e vetëpërcakimit.

Kosova, duke e forcuar sovranitetin e vet, sidomos në drejtimin e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, e zgjidh përfundimisht çështjen e pazgjidhur kombëtare të kësaj pjese të popullit shqiptar.

Lëvizja për Bashkim do të përpiqet që forcimi i sovranitetit të Kosovës të shkojë në drejtim të bashkimit kombëtar, në mënyrë që të zgjidhet përfundimisht çështja kombëtare në Kosovë.

e) Integrimet kombëtare dhe çështja e pazgjidhur kombëtare

Integrimet brenda kombit shqiptar janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të popullit shqiptar. Ky proces, po të mos ishin pengesat e jashtme, do të çonte natyrshëm edhe në zgjidhjen e plotë të çështjes shqiptare – bashkimin e popullit shqiptar në një shtet të vetëm.

Ligjet e shtetit serb, maqedonas e malazias, të cilat janë në mbrojtje të pushtimit të tokave shqiptare, si dhe Pakoja e Ahtisarit, janë pengesat kryesore të integrameve kombëtare shqiptare.

Në këto rrethana, përkundër pengesave, integrimet kombëtare brenda popullit shqiptar mund të bëhen në shumë fusha të jetës, si në arsim, kulturë, sport e në disa sfera të ekonomisë, por nuk mund të bëhen në sferën e juridiksionit, në ushtri, në polici, në sistemin doganor e në atë tatimor etj.

Pra, integrimet kombëtare janë një ndihmesë në rrugën e bashkimit kombëtar, por nuk mund ta zëvendësojnë bashkimin.

f) Integrimet ndërkombëtare dhe bashkimi kombëtar

Integrimet ndërkombëtare, ku nënkuptohet para së gjithash procesi i integrameve evropiane (integrimin në BE), sado që mund të sjellin dobi, Lëvizja për Bashkim nuk i konsideron si zëvendësim të procesit të bashkimit kombëtar.

Për më tepër, hyrja e rajonit tonë në BE me probleme të pazgjidhura kombëtare do të jetë faktor potencial destabilizimi për vetë BE-në.

Sidoqoftë, Lëvizja për Bashkim në thelb këtë proces nuk e sheh të dëmshëm për procesin e bashkimit kombëtar, sidomos nëse ky proces do të ndihmojë në demokratizimin e brendshëm të shteteve të rajonit të Ballkanit. Ky proces demokratizimi do të jetë një parakusht i rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve kombëtare në Ballkan.

Lëvizja për Bashkim konsideron se ky proces nuk duhet të zhvillohet në dëm të asnjë kombi, e aq më pak të kombit shqiptar, i cili është ende i copëtuar në pesë shtete, por duhet të zhvillohet në drejtim që secili komb të vendosë në mënyrë të

pavarur se cilit entitet shtetëror dëshiron t'i takojë. Lëvizja për Bashkim konsideron se integrimi i shteteve ballkanike në mekanizmat ndërkombëtarë mund të jetë një rast i mirë për rregullimin e padrejtësive historike të bëra në kurriz të popullit shqiptar, duke i mundësuar atij që aty ku është shumicë dhe ka vazhdimësi territoriale ta ushtrojë të drejtën e vet për vetëvendosje deri në shkëputje dhe për bashkim me shtetin shqiptar.

g) Pakicat kombëtare

Pakicat kombëtare në Kosovë Lëvizja për Bashkim nuk i konsideron si pengesë të zhvillimeve në Kosovë, e as rrezik për kombin shqiptar. Për më tepër ato duhet të shërbejnë si një urë lidhëse dhe miqësie në mes të kombit shqiptar dhe kombeve që këto pakica u përkasin. Në këtë funksion Lëvizja për Bashkim konsideron se pakicat kombëtare dhe pjesëtarët e tyre në Kosovë duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat për pakica kombëtare dhe të gjitha të drejtat e njeriut të bazuara në standardet më të lartë ndërkombëtare (Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Evropës, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave etj.).

Sidoqoftë, Lëvizja për Bashkim vlerëson se pakica serbe në Kosovë në vazhdimësi është manipuluar dhe instrumentalizuar nga ana e regjimeve pushtuese serbe. Fatkeqësisht edhe bashkësia ndërkombëtare në Kosovë nga viti 1999 e këtej e ka vazhduar manipulimin për interesa të veta. Madje, në këtë periudhë pakica serbe është favorizuar edhe në raport me pakicat e tjera kombëtare në Kosovë. Ky manipulim dhe instrumentalizim me pakicën serbe ka bërë që marrëdhëniet në mes të shumicës shqiptare dhe pakicës serbe të jenë shumë të këqija. Plani i Ahtisarit, duke i dhënë favore që nuk mund t'i takojnë një pakice kombëtare, ka bërë që ky manipulim me pakicën serbe të vazhdojë. Raportet ndëretnike në terren janë në nivele të larta tensioni dhe rrjedhimisht edhe situata e sigurisë paraqitet mjaft problematike për shkak të ndikimit të vazhdueshëm të Beogradit në serbët e Kosovës dhe bojkotit që serbët i bëjnë çfarëdo integrimi në jetën institucionale të Kosovës.

Lëvizja për Bashkim mendon se qasja e Planit të Ahtisarit për rregullimin e pozitës së pakicave dhe posaçërisht asaj serbe në Kosovë nuk e rregullon pozitën e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me shumicën. Për më tepër, ky rregullim është një model që në vazhdimësi do t'i destabilizojë marrëdhëniet në mes të shumicës dhe pakicave, sidomos asaj serbe. Lëvizja për Bashkim konsideron se pozita e pakicës serbe në Kosovë (këtu nuk përfshihen serbët në veri të Kosovës) duhet të rregullohet duke u respektuar standardet e përmendura më lart, si për pakicën serbe, ashtu edhe për pakicat e tjera.

Vetëm në këtë mënyrë Lëvizja për Bashkim beson se do të krijohen parakushtet për një shtendosje të raporteve ndëretnike në Kosovë dhe për jetë në fqinjësi të mirë në mes të shqiptarëve dhe serbëve në përgjithësi dhe të atyre në Kosovë në veçanti.

2) Prezenca ndërkombëtare në Kosovë

Në situatën aktuale LB-ja e konsideron të domosdoshme praninë paqeruajtëse ndërkombëtare në Kosovë pikërisht për shkak të mungesës së forcës mbrojtëse të Kosovës dhe mundësisë që sërish të shpërthejë lufta.

Forcat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, në cilëndo formë qofshin - KFOR, UNMIK, EULEX apo në ndonjë formë tjetër, LB-ja i konsideron si forca të huaja, të cilat duhet të qëndrojnë në Kosovë vetëm në përputhje me vullnetin e shumicës së popullsisë dhe të institucioneve të saj.

Pavarësisht prej faktorëve që kanë kontribuar për ardhjen e këtyre forcave, sapo të krijohen kushtet për largimin e tyre, ato duhet të largohen në mënyrë krejt miqësore nga Kosova dhe ta mundësojnë zhvillimin e plotë demokratik të saj.

Prandaj, Lëvizja për Bashkim konsideron se duhet të punohet në krijimin ushtrisë së Kosovës si garanci e paqes në Kosovë dhe si garanci e paprekshmërisë së territorit të saj, e cila paprekshmëri mund të cenohet vetëm nga vetë vullneti i shumicës së popullsisë (p.sh. përmes vetëvendosjes së kombeve – bashkimi me Shqipërinë).

3) Rezoluta 1244 e OKB-së

Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës Rezoluta 1244 e KS të OKB mbeti akoma në fuqi.

Rezoluta 1244, duke ia njohur Serbisë sovranitetin mbi Kosovën, cenon rëndë interesin dhe të drejtat e shumicës së popullsisë së Kosovës. Prandaj, për LB-në Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara është plotësisht e papranueshme dhe ajo në të gjithë veprimtarinë e vet politike do të përpiqet për moszbatimin e kësaj rezolute.

Lëvizja për Bashkim do të kërkojë në vazhdimësi që Rezoluta 1244 të shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një rezolutë të re ku do të pranohej realiteti i ri pas shpalljes së pavarësisë dhe shumicës shqiptare do t'i njihej e drejta e vullnetit politik deri në vetëvendosje.

4) Pakoja e Ahtisarit

Për Lëvizjen për Bashkim Pakoja e Ahtisarit si zgjidhje e problemit të Kosovës është plotësisht e papranueshme. Arsytet kryesore pse kjo Pako është e papranueshme për LB-në janë:

- a) Pakoja e Ahtisarit shqiptarët si popullsi shumicë në Kosovës nuk i trajton si komb, por si komunitet dhe rrjedhimisht e cenon interesin kombëtar të tyre;
- b) Popullit shqiptar në Kosovë ia mohon të drejtën e ushtrimit të sovranitetit mbi territorin e vet dhe njëkohësisht ia mohon të drejtën e kombeve për vetëvendosje;
- c) Problemin shqiptaro-serb në Kosovë jo që nuk arrin ta zgjidhë, por e komplikon dhe e ashpëron akoma më shumë;
- d) Duke iu krijuar privilegje të skajshme serbëve në dëm të shumicës shqiptare dhe të minoriteteve të tjera, Pakoja e Ahtisarit riprodhon në vazhdimësi armiqësi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, armiqësi e krijuar historikisht nga shovinizmi serb;
- e) Duke ia mohuar popullit shqiptar të Kosovës të drejtën për vetëvendosje, i mban gjallë dhe i ushqen pretendimet shoviniste e hegjemoniste të Serbisë ndaj Kosovës;
- f) Duke i lënë të gjitha problemet të pazgjidhura, Pakoja e Ahtisarit Kosovën e bën një shtet plotësisht jofunksional.

Duke qenë kështu LB-ja do të angazhohet për moszbatimin e kësaj Pakoje dhe do të përpiqet për zgjidhjen e vërtetë të çështjes së Kosovës – bashkimin me Shqipërinë.

5) Kushtetuta e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm juridik i Kosovës. Si i tillë, në të mirë të qytetarëve të Kosovës është dashur që të jetë pasqyrë e plotë e realitetit si dhe t'u japë zgjidhje juridike situatave të ndryshme politike, ekonomike etj.

Kushtetuta e Kosovës nuk e arrin as për së afërmi këtë qëllim. Ajo në tërësinë e saj është një dokument kontradiktore ku shumica e neneve bien ndesh, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me nenin e parë të saj në të cilin thuhet: *“Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm”*. Pastaj ajo, duke iu nënshtruar plotësisht Pakos së Ahtisarit, e mohon vullnetin e shumicës shqiptare për ta ushtruar sovranitetin në territorin ku jeton.

Lëvizja për Bashkim në vazhdimësi do të përpiqet për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës në përputhje me Nenin e parë të saj dhe sidomos do të përpiqet që ta sanksionojë ligjërisht në Kushtetutë të drejtën e kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje. Vetëm kështu do të ndreqeshin padrejtësitë shekullore që i janë bërë popullit shqiptar dhe do të krijohet mundësia që populli shqiptar i Kosovës nëpërmjet institucioneve ta shprehë vullnetin e plotë të tij.

6) Qëndrimi i LB-së për zgjedhjet dhe qeverisjen në Kosovë

Lëvizja për Bashkim zgjedhjet e lira i konsideron mekanizëm të nevojshëm e të domosdoshëm për vendosjen e pushtetit, si atij qendror, po ashtu edhe atij lokal.

a) Zgjedhjet e lira në Kosovë

Organizimin e zgjedhjeve të lira në Kosovë LB-ja e quan një proces normal dhe të domosdoshëm, edhe pse mendon se zgjedhjet në Kosovë nuk kanë qenë, e as nuk kanë mundur të jenë plotësisht të lira e demokratike as që nga përfundimi i luftës e këtej.

Zgjedhjet në Kosovë deri më tani nuk janë organizuar nga vendorët, kështu që nuk i kanë pasqyruar plotësisht nevojat dhe interesin e elektoratit të saj. Këto nevoja dhe interesa në raport me zgjedhjet paraqiten drejtpërdrejt në ligjin zgjedhor.

Përpiluesit e ligjit zgjedhor të Kosovës, duke u nisur nga qëndrimi i gabuar i politikës aktuale për një Kosovë multietnike, si dhe në emër të diskriminimit pozitiv janë përpjekur që edhe Kuvendi i Kosovës të ketë përmbajtje multietnike dhe në këtë mënyrë, duke mos e paraqitur besnikërisht situatën në terren, e kanë cenuar interesin e shumicës dërrmuese të popullsisë.

Faktor tjetër që i bën zgjedhjet në Kosovë jo plotësisht të lira është edhe mohimi i së drejtës për vetëvendosje që i është bërë popullit shqiptar të Kosovës. Kjo bën që subjektet që e kanë në program një qëllim të tillë të mos i nënshtrohen një vullneti të lirë të qytetarëve, por një vullneti të kushtëzuar.

Në anën tjetër, që nga përfundimi i luftës në Kosovë, zgjedhjet mbahen në praninë e forcave ushtarake e civile (administrative) të huaja dhe është i pashmangshëm ndikimi psikologjik mbi zgjedhësin e Kosovës. Shpeshherë ky ndikim ka qenë edhe i drejtpërdrejtë dhe është manifestuar me përkrahje të hapur apo të fshehur të subjekteve të caktuara politike.

Prandaj, Lëvizja për Bashkim zgjedhjet në Kosovë i konsideron si zgjedhje jo plotësisht të lira dhe jo plotësisht demokratike.

b) Pjesëmarrja e LB-së në zgjedhje

Lëvizja për Bashkim në parim merr pjesë në zgjedhjet në Kosovë dhe do t'i quajë e do t'i konsiderojë ato si një mjet për arritjen e qëllimeve të saj. Duke qenë kështu dhe duke pasur parasysh dy qëllimet kryesore të LB-së, – bashkimin kombëtar dhe mbrojtjen e interesit të përditshëm të qytetarit, - Lëvizja për Bashkim do të marrë pjesë edhe në zgjedhjet që do të organizohen për nivelin lokal, edhe për ato në nivel qendror.

Meqenëse Lëvizja për Bashkim zgjedhjet i quan si jo plotësisht të lira dhe jo plotësisht demokratike, ajo mendon se edhe qeveritë e dala nga këto zgjedhje nuk do të jenë plotësisht demokratike. Pra, institucionet e Kosovës, duke qenë se nuk janë plotësisht demokratike, do të miratojnë ligje dhe do t'i zbatojnë ato ekskluzivisht në përputhje me Pakon e Ahtisarit (të cilën ne nuk e pranojmë), e jo me vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Për të gjitha këto ligje me të cilat populli nuk do të pajtohet për shkak se janë në kundërshtim me vullnetin e tij, nëse do të jetë e pamundur të pengohen në mënyrë institucionale, LB-ja do të t'i organizojë qytetarët përmes rrugëve jashtinstitucionale në shprehjen e mospajtimit të tyre.

Prandaj, Lëvizja për Bashkim në programin e saj e ka paraparë edhe përdorimin e mjeteve jashtinstitucionale të veprimit.

Mjetet jashtinstitucionale janë: grevat, protestat, demonstratat dhe forma të tjera të mosbindjes qytetare.

c) Pjesëmarrja e LB-së në qeverisje

Me anë të pjesëmarrjes në zgjedhjet qendrore LB-ja synon të hyjë në Kuvendin e Kosovës dhe aty ta mbrojë hapur dhe me vendosmëri çështjen e bashkimit kombëtar, interesin e vërtetë të qytetarit të Kosovës, si dhe të luftojë për demokratizimin e plotë të jetës politike në Kosovë.

LB-ja do të ketë qasje të ndryshme për nivelet e qeverisjes. Derisa ne do të marrim pjesë në zgjedhje dhe në të gjitha organet e pushtetit në nivel lokal, ne do të marrim pjesë në zgjedhjet për pushtetin qendror, por nuk do të marrim pjesë në asnjë qeveri e cila do të bjerë në kundërshtim me qëllimet tona kryesore apo me programin tonë politik.

Në rastin kur Lëvizja për Bashkim do ta ketë shumicën në Kuvendin e Kosovës, ajo do ta formojë Qeverinë e Bashkimit Kombëtar.

Pushtetin nëpër komuna LB-ja e konsideron si pushtet administrativ dhe do të marrë pjesë në të gjitha hallkat e tij, kurse synimi kryesor në këtë drejtim do të jetë përmirësimi i jetës së qytetarit.

d) Zgjedhjet, vota dhe pushteti

Derisa të gjitha partitë politike në Kosovë qëllim të veprimtarisë së tyre politike e kanë marrjen e pushtetit, ato nuk zgjedhin mjete për të arritur deri te ky qëllim. Për t'iu shmangur kontrollit të qytetarit në mënyrë që të sundojnë më lehtë, partitë politike dhe liderët e tyre përpiqen që sa më tepër ta pasivizojnë politikisht qytetarin, në mënyrë që me anë të premtimeve e manipulimeve të arrijnë deri te vota e tij, për të cilën votuesi nuk do të duhej të interesohej më tutje. Këtë votë ne e quajmë votë pasive dhe e konsiderojmë si burimin kryesor të zvetënimit të demokracisë. Në këtë mënyrë, me jetën e qytetarit votues të pasivizuar luhet në mënyrë të pamëshirshme.

Lëvizja për Bashkim konsideron se qytetari i Kosovës duhet të jetë politikisht aktiv dhe kur ta hedhë votën e tij të dijë pse po e hedh dhe sidomos të jetë në gjendje ta mbrojë atë. Këtë lloj vote ne e quajmë votë aktive dhe e konsiderojmë si burimin kryesor të demokratizimit të jetës politike në Kosovë.

Lëvizja për Bashkim nuk është e interesuar dhe nuk do ta kërkojë asnjëherë votën pasive të qytetarit. Ajo, meqenëse përpiqet për realizimin e qëllimeve të caktuara politike dhe meqenëse qytetarin e konsideron faktor kryesor për realizimin e interesit të tij, do të përpiqet për aktivizimin e plotë të qytetarit, qoftë në raport me interesin e tij të përditshëm, qoftë në raport me qëllimet kombëtare.

7) Qeverisja dhe interesi i përditshëm i qytetarit

Asnjë qeverie të deritashme në Kosovë nuk i ka interesuar fare gjendja e qytetarit. Për qytetarin ato janë kujtuar vetëm kur i janë dashur paraja dhe vota e tij. Me paranë dhe votën e tij është abuzuar në mënyrë të pamëshirshme. Si rrjedhojë kemi një jetë shoqërore të degraduar në çdo aspekt dhe në të gjitha sferat e shoqërisë.

Qeverisja në Kosovë karakterizohet me një papërgjegjësi, paaftësi, servilizëm e snobizëm të padurueshëm.

Ekonomia karakterizohet me anarki e korrupsion.

Jeta sociale karakterizohet me varfëri të skajshme, papunësi e paperspektivë.

Arsimi e shëndetësia janë në një gjendje të mjerueshme.

Jeta kulturore e shpirtërore e popullit karakterizohet me një degradim të plotë moral, e kështu me radhë.

Si pasojë e kësaj gjendjeje ne sot kemi një zhgënjim të qytetarit jo vetëm në këtë apo atë qeveri, por në qeverisjen në përgjithësi.

Lëvizja për Bashkim konsideron se ky besim i humbur i qytetarit mund dhe duhet të kthehet dhe ai kthehet vetëm duke e bërë qytetarin pjesë të vendimmarrjes si në çështjet politike, ashtu edhe në ato sociale.

III

ÇËSHTJET TË CILAT KËRKOJNË PËRQENDRIM NË PERIUDHËN DYVJEÇARE

- 1) Mbrojtja e interesit kombëtar shqiptar (Lëvizja për Bashkim do të angazhohet me të gjitha forcat në drejtim të propagandimit e të fuqizimit të kërkesës për bashkim kombëtar, si dhe institucionalizimit të saj; në të njëjtën kohë, Lëvizja për Bashkim do të luftojë pa kompromis kundër tendencave shkombëtarizuese dhe përpjekjeve për përçarje brenda kombit);
- 2) Zgjidhja e çështjes shqiptaro-serbe (Presheva, Bujanoci e Medvegja dhe veriu i Kosovës);
- 3) Jeta e përditshme e qytetarit dhe mbrojtja e interesave të tij (Lëvizja për Bashkim zotohet se do të koncentrohet në pesë shtylla të shoqërisë: ekonomi; arsim; shëndetësi; çështje sociale dhe mbrojtje të ambientit).